REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 64 datë 26.10.2020

**"Për dhenjen në perdorim te siperfaqes pyjore prej 40.3 ha me afat 9 vjeçar për ndertim teleferik pasagjeresh ose linje të tensionit, aerogjeneratore (stacionet,objektet perkatese etj"në ekonominë pyjore Drin Gjader Kire."**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "el", neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 25 pika 1 e ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "*Për Pyjet* ", **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullesor publik:

**KËSHILLI BASHKIAK**
**VENDOSI**

**1** Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **40.3** ha ""**Per ndertim teleferik pasagjeresh ose linje te tensionit, aerogjeneratore (stacionet,objektet perkatese etj,në ekonominë pyjore Drin Gjader Kire.**"në **ngastrën nr.4 dhe10** të ekonomine pyjore **Drin Gjader kire me afat 9 vjeçar** .

**2.**Vlera vjetore e dhënies me qira të jete sipas studimit teknik-ekonomik bashkëlidhur,sipas VKM nr.1064,date 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

**3.** Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.

**4.** Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe Turizmit për zbatimin e ketij vendimi.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
**ARDIAN ÇELEPIJA**

**ZV KRYETAR**
**ERVIS SHIMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

Miratuar me 24 vota
Vota Pro 24
Vota Kunder –
Vota Abstenim –
Zbardhur me datë 30.10.2020

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL DHE TURIZMIT**

Adresa, *Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës* nr. Tel: *Telefon/Faks 00355 2612 0006*, e-mail *e-mail: info@vaudejes.gov.al*

**PROJEKT VENDIM**

Nr. ___6___ datë ___09.03.___2020

**"Për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 40.3 ha me afat 9 vjeçar për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjeneratore ( stacionet, objektet përkatëse etj", në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kir"**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e, l" neni 18, pikA 2, të Ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015" Për vetëqeverisjen vendore", neni 25, pika 1 e Ligjit nr 57/2020 datë 30.04.2020 " Për pyjet", pika 49 e VKM-së nr 433 datë 08.06.2016, " Për transferimin në pronësi të bashkive , të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e t ëish komunave/bashkive", Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 09.06.2016 " Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit e të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 40.3 ha " Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjeneratore ( stacionet, objektet përkatëse etj), në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kir", në ngastrën nr 4. dhe 10 të ekonomisë pyjore Drin Gjadër Kir me afat 9 vjeçar.
2. Vlera vjetore e dhënies me qira të jetë sipas studimit teknik-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM nr 1064, datë 22.12.2010 " Për disa ndryshime në vendimin nr 391 datë

21.06.2006 të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"

3. Efektet : Jep impakte pozitive tek komuniteti, sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**K R Y E T A R**
**MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**KRISTIAN SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Konceptoi bazën ligjore**
**Kristinë Shtatri**
**Përgati:**
**Zeqir Ujka**
**Miratoi:**
**Drejtor:**
**Rrok Ftoni**

Bashkia Vau Dejës *Shtojca nr. 1*

# RAPORT

## MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGAFONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS

"PËR PARK FOTOVOLTAIK", AEROGJENERATORE (STACIONET,OBJEKTET PERKATESE ETJ).

Bazuar në **Urdhërin nr.33,** datë 03.02.2020 të Kryetarit të Bashkise për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira "Grupi i punës i përbërë nga z.Zeqir Ujka Përgjegjës i sektorit të pyjeve z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve ,z.Esmeraldo Harapi specialist kadastre, nga data **02.03.2020** deri në datën **06.03.2020** ,studjoi kërkesën **e z. Ferdinand Gavoqi** dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullosore me objekt dhënien në përdorim të siperfaqes pyjore **40.3** ha **"për park fotovoltaik", (aerogjeneratore,stacionet,objektet perkatese etj).**

Mbështetur në të dhënat e rregjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433,datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive,rezulton që sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **40.3** ha per **"për park fotovoltaik", (aerogjeneratore,stacionet,objektet perkatese etj) në total e ndare në: ngastren nr.4** ekonomia pyjore **Drin Gjader Kire 35 ha,ngastren nr.10** ekonomia pyjore **Drin Gjader Kire 5.3 ha** sipas listës së inventarit,**shtojca nr.47**, janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.
Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).*
Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga "Ferdinand Gavoçi",jepen në përdorim për një afat **9 vjet** një siperfaqe prej **40.3 ha "për park fotovoltaik", (aerogjeneratore,stacionet,objektet perkatese etj).**

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353,datë 10.10.2008,të ndryshuar"Përrregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar"Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor". Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016"Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" pika nr 2 germa (a) dhe pika 7.

*Siperfaqja e marrë në studim do ti nënshtrohet* procedurës së Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër,kryetari Bashkise nxjerr urdherin për pregatitjen e dokumentave të ankandit nepermjet proçedurës së kunkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-venë nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"lidhja 2 pika 8,/5 si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

**Shuma në lek/vit konsiston në:**

**1. Vlerën e përdorimit leke/ha/vit për "për park fotovoltaik", aerogjeneratore (stacionet,objektet perkatese etj)."**

a) Ngastra nr.4 ,siperfaqe djerre prej 35 ha x 143 000 leke = **5 005 000** lekë ne vit
b) Ngastra nr.10 ,siperfaqe djerre prej 5.3 ha x 143 000 leke = **757 900** lekë ne vit

**Në total 5 762 900 lekë ne vit.**

**PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK**

**Ing.Zeqir Ujka** **Ing. Mark Suli** **Ing. Esmeraldo Harapi**

**KRYETARI**
**MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETAR**
**KRISTIAN SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas regjistrit kadastral)
"PËR PARK FOTOVOLTAIK", AEROGJENERATORE (STACIONET,OBJEKTET PERKATESE ETJ).

Formulari nr.1

| ID. Prones | Ekonomia Pyjore | Parcela | Sip.Tot. ha | Perberja grumbullit | Funksioni | Forma Qeverisjes | Mosha | K.D | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | Per ha | Total |
| SH22 0004 | Drin Gjader Kir | 4 | 237.45 | Djerre | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| SH22 0010 | Drin Gjader Kir | 10 | 42.24 | Djerre | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Gjithsejt** | | | 279.69 | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**PLOTESOI:**

**Ing.Esmeraldo Harapi** **Ing.Mark Suli** **Ing. Zeqir Ujka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS - SEKRETARIA

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas verifikimit ne terren)

"PËR PARK FOTOVOLTAIK", AEROGJENERATORE (STACIONET,OBJEKTET PERKATESE ETJ).

Formulari 2

| ID. Prones | Ekonomia Pyjore | Parcela | Sip.Tot. ha | Perberja grumbullit | Funksioni | Forma Qeverisjes | Mosha | K.D | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | Per ha | Total |
| SH22 0004 | Drin Gjader Kir | 4 | 237.45 | Djerre | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| SH22 0010 | Drin Gjader Kir | 10 | 42.24 | Djerre | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Gjithsejt** | | | 279.69 | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**PLOTESOI:**

**Ing.Esmeraldo Harapi** **Ing.Mark Suli** **Ing. Zeqir Ujka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS - SEKRETARIA

**Bashkia Vau Dejës**

## TABELA PERMBLEDHESE E VLERESIMIT FINANCIAR

"PËR PARK FOTOVOLTAIK", AEROGJENERATORE (STACIONET,OBJEKTET PERKATESE ETJ).

**Formulari nr.4**

| Perdorimi I territorit | Sip ha | Bashkia | Volumi ne $m^3$ sipas asortimenteve | Sasia | Vlera Leke /m3 | Shuma I | Gjatesia e perdorimit rruge ne km | Tarifa dhenje ne perdorim lek/ha/vit | | | Shuma II | Totali I+II |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 1 | 2.-5 | 6.-10 | | |
| 0 | 1 | 2 | 3 | | 4 | 5 | 6 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| Pyll | 0 | V.Dejës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pyll | 0 | V.Dejës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Djerre | 40.3 | V.Dejës | | | | | | 156 000 | 150 000 | 143 000 | 5 762 900 | 5 762 900 |
| Gjuetia | 0 | V.Dejës | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Invest | 0 | V.Dejës | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Gjithsejt** | 40.3 | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**PLOTESOI:**

**Ing.Mark Suli** **Ing.Zeqir Ujka** **Ing.Esmeraldo Harapi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA VAU I DEJËS SEKRETARIA

**Bashkia Vau Dejës**

**LISTA E NGASTRAVE, N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM "PËR PARK FOTOVOLTAIK", AEROGJENERATORE (STACIONET,OBJEKTET PERKATESE ETJ).**

| Nr. | ID Prones | Ekonomia Pyjore/kullosore | Ng/neng,nr. | Siperfaqie qe hiqet nga fondi pyjor/kullosor | Siperfaqja | Gjatesia ne perdorim km | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Siperfaqja qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor ha | Rruge km | Linje | Tubacion/ kanal |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 1 | SH22 0004 | Drin Gjader Kir | 4 | 0 | 35 | 0 | 0 | 0 |
| 1 | SH22 0010 | Drin Gjader Kir | 10 | 0 | 5.3 | 0 | 0 | 0 |
| **Shuma** | | | | | **40.3** | | | |

**PLOTESOI:**

**Ing.Mark Suli** **Ing.Zeqir Ujka** **Ing .Esmeraldo Harapi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS - SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VAU DEJËS**
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL DHE TURIZMIT**
**Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA VAU I DEJËS

Nr. 16 prot. Vau Dejës, më 09.03.2020

**RELACION**

"PËR PARK FOTOVOLTAIK",AEROGJENERATORE(STACIONET,OBJEKTET PERKATESE ETJ).

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 9385/2005 "Për fondin pyjor " i ndryshuar", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
Bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore",neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.
Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 " Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" pika 7, Vendim nr 3 datë 27.04.2018 për miratimin e planit të përgjithshëm vendor.

*Siperfaqja e marre në studim do ti nënshtrohet* proçedures së konkurimit publik sipas legjislacionit ne fuqi.

**Siperfaqja që kerkohet të merret në përdorim ështe 40.3 ha.**

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vudejes.gov.al*

Në funksion të siperfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-venë nr.1064, date 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" lidhja 2 pika 8/5, **si më poshtë.**

| 8. Per ndertim teleferik pasagjeresh ose linje te tensionit, aerogjeneratore (stacionet,objektet perkatese etj.). | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përdorimi i territorit | Siperfaqia e përdorur në Ha | Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit | |
| | | 1 vit | 2- 5 vjet | 6-10 vjet |
| 1 | Toke me Bimësi pyjore djerr | 156.000 | 150.000 | 143.000 |

**Vlera totale e pagesës/vit është 5 762 900 (pesemilion shtaeqind gjshtedhjete e dy mije e nenteqind) lekë.**

**Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të siperfaqes prej 40.3 ha "për park fotovoltaik", (aerogjeneratore,stacionet,objektet perkatese etj).**

**Bashkëlidhur po ju dergojmë.**
**1.Dokumentacionin e plote dhe harten e ekonomise.**
Duke ju falënderuar, ju ftojmë në miratimin e projekt vendimit.

**Grupi i Punes**

**Ing.Mark Suli** **Ing.Zeqir Ujka**

**Miratoi**
**Drejtori**
**Rrok Ftoni**

# Ekonomia Pyjore Drin-Gjader-Kir

SH 1:10 000




Stajka

| Koordinatat Sistemi Alb.1986, Ferdinand Gavoçi | | | |
|---|---|---|---|
| Nr i ngastres | Nr i pikes | X | Y |
| S1 4 | 1 | 4384265 | 4653181 |
| S1 4 | 2 | 4384149 | 4653320 |
| S1 4 | 3 | 4383943 | 4653196 |
| S1 4 | 4 | 4384084 | 4653040 |
| | | | |
| S2 4 | 5 | 4384044 | 4652985 |
| S2 4 | 6 | 4383840 | 4653211 |
| S2 4 | 7 | 4383472 | 4652927 |
| S2 4 | 8 | 4383906 | 4652874 |
| | | | |
| S3 4 | 9 | 4383753 | 4652736 |
| S3 4 | 10 | 4383300 | 4652792 |
| S3 4 | 11 | 4382725 | 4652452 |
| S3 4 | 15 | 4383124 | 4652379 |
| S3 4 | 16 | 4383344 | 4652458 |
| S3 4 | 17 | 4383518 | 4652557 |

| Nr i ngastres | Nr i pikes | X | Y |
|---|---|---|---|
| S4 4 | 12 | 4382460 | 4652295 |
| S4 4 | 13 | 4382714 | 4652295 |
| S4 4 | 14 | 4383071 | 4652360 |
| S4 4 | 15 | 4383124 | 4652379 |
| S4 4 | 11 | 4382725 | 4652452 |

| Parcela | Ngastra | Siperfaqja ne hektar (ha) |
|---|---|---|
| S1 | 4 | 4.6 |
| S2 | 4 | 9.8 |
| S3 | 4 | 20.6 |
| S4 | 10 | 5.3 |
| | | |
| | | |
| | | |
| Sip.totale | | 40.3 |

**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**

**BASHKIA VAU DEJËS**

**DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT**

**SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Adresa, *Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës* nr. Tel: *Telefon/Faks 00355 2612 0006*, e-mail *e-mail: info@vaudejes.gov.al*

DATA 30.09.2020

# RELACION

**" Për miratimin e projektvendimit të ri , që lidhet me vendimin nr 34 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës"**

- *Vendimin nr 34 dt 25.06.2020 "Për dhënien ne përdorim të sipërfaqes pyjore prej 40.3 ha me afat 9 vjecare " për park fotovoltaik" ( aerogjenerator, stacione, objekte perkatese etj) në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kir"*

Lidhur me këtë vendim është shprehur Prefekti Shkodër , me shkresën nr 499/3 dt 30.07.2020, mbërritur pranë Bashkisë Vau Dejës me dt 03.08.2020, ku citohet se duhet ti drejtohemi Zyres se Administrimit të Basenit Ujor Drin- Bune për marrjen e informacionit mbështetur në Ligjin nr 111/2012 " Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

Me shkresën nr 352 dt 21.08.2020, Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin Bune , ka kthyer përgjigje :

Zona ku është parashikuar dhënia e tokës në përdorim me VKB nr 11, 34, 35, 36, 37, 43, 44, 45 është brenda shtratit dhe brigjeve të Lumit Drin.

Në nenin 5 të Ligjit nr 111/2012 i ndryshuar, përcaktohet që pronësia e shtretërve të lumenjve dhe brigjeve është e patjetërsueshme por nuk përjashton dhënien me qira sipas Ligjeve në fuqi.

Në zbatim të nenit 66 të Ligjit , përcaktohet që lejohet veprimtaria ndërtimore në brigje vetëm për qëllime publike, ndërsa në nenin 67 janë të përcaktuara veprimtaritë e ndaluara në brigje.

Rrjedhimisht veprimtarite e parashikuara nuk janë në shkelje të nenit 67, konkretisht : nuk ka ndryshim apo zhvendosje të mbulesës bimore natyrore apo artificial, sipas nenit 67, pika 1/a, nuk do ketë marrje të materialeve inerte , rërë zhavorr, gurë apo plisa, sipas nenit 67, pika 1/b; nuk do ketë ndërtimi i vendeve të parkimit për mjete ujore dhe automjete tokësore, sipas nenit 67, pika 1/c; nuk do te ketë krijimi i vendeve të thata për rrjetat, sipas nenit 67, pika 1/ç; nuk do ketë gërmimi, shpimi ose shpëlarjet , sipas nenit 67, pika 1/d; nuk do ketë hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gërmimeve të ndryshme, si dhe veprimtarive të tjera që gjenerojnë mbetje, sipas nenit 67, pika 1/dh; nuk do ketë shkarkim të ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara, sipas nenit 67, pika 1/e, kërkojme nga Këshilli i Bashkisë Vau Dejës të rivotojë projektvendimet , në përputhje me nenin 16 pika 2/b gërma ii) të Ligjit " Për prefektin " … *vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës "a", të kësaj pike;*

Pasi është rishqyrtuar akti, rezulton të jetë plotësisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE, ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE KONTRATAVE**

**Përgjegjës**

**Kristinë Shtatri**